



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2024:013724
Datë: 25.09.2024
Numri i dokumentit: 06208450

CA.nr.9785/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Naime Ahmeti – kryetare e kolegjit, Hidajete Gashi Alaj dhe Bujar Muzaqi, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit/propozuesit të masës B.B. me vendbanim ..., nr..., në Fushë Kosovë dhe L.T., me vendbanim P., Komuna Viti, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Shoqëria e avokatëve “G.H.G.” sh.p.k me seli në Prishtinë, Rr. “...”, ..., nr.. Prishtinë, kundër të paditurit – palës kundërshtare B.H. me vendbanim Rr. ”...”, nr..., në Gjilan, lidhur me çështjen juridike padi për shpifje, me propozim për masë të sigurisë, duke vendosur lidhur me ankesën e përfaqësuesit të autorizuar të propozuesve, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.277/2024 të datë 30.04.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 25.09.2024, mori këtë :

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të paditësve/propozuesve për masë të sigurisë B.B. nga Fushë Kosova dhe L.T. nga P., Komuna Viti, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr. 277/2024 të datë 30.04.2024, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin, C.nr.277/2024 të datë 30.04.2024, ka vendosur si vijon:

I. “REFUZOHET si i pabazuar propozimi i propozuesve B.B. me vendbanim ..., nr..., Fushë Kosovë dhe L.T., me vendbanim P., Komuna Viti, për caktimin e masës së sigurimit, me të cilin ka kërkuar që të paditurit–kundërshtarit të sigurimit B.H. nga Gjilani, ti ndalohej publikimi i çfarëdo deklarate, postimi, komenti, ose informacioni që ka të bëjë me B.B. dhe L.T., si dhe

urdhërohet kundërshtari i masës se sigurisë që të fshije të gjitha postimet dhe komentet që kanë të bëjnë me propozuesit e sigurimit, derisa të përfundoj procedura me aktgjykim nga gjykata në lidhje me këtë padi.

II.Procedura në këtë çështje juridike-kontestimore do të vazhdoj sipas rregullave të procedurës kontestimore dhe sipas planit të punës së gjykatës”.

Kundër këtij aktvendimi brenda afatit ligjor, ka paraqitur ankesë përfaqësuesi i autorizuar i propozuesve, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit, me propozim që Gjykata e Apelit ankesën e propozuesit të masës së sigurimit ta aprovoj si të bazuar, aktvendimin e atakuar ta anuloj ashtu që çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Gjykata e Apelit, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, si dhe analizimin dhe vlerësimin e shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 pika (b) të Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore, ka gjetur se :

-Ankesa e propozuesve të masës së sigurimit, është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se propozuesit e masës së sigurisë, nëpërmes të autorizuarit të tyre pranë gjykatës së shkallës së parë me datë 15.01.2024, kanë ushtruar padi kundër të paditurit B.H. për shpifje, ndërsa me datë 05.03.2024 kanë parashtruar propozim për caktimin e masës se sigurisë, kundër të paditurit – kundërshtarit të sigurimit B.H., me të cilën kanë kërkuar që t'i ndalohe publikimi i çfarëdo deklarate, postimi, komenti, ose informacioni që ka të bëjë me propozuesit B.B. dhe L.T., si dhe urdhërohet kundërshtari i masës se sigurisë që të fshije të gjitha postimet dhe komentet që kanë të bëjnë me propozuesit e sigurimit, derisa të përfundoj procedura me aktgjykim sipas padisë për shpifje.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas propozimit të propozuesit për caktimin e masës së sigurimit, ka mbajtur seancën dëgjimore për shqyrtimin e propozimit për caktimin e masës së sigurisë, dhe pas analizimit të tërësishëm të provave, me aktvendimin C.nr. 277/2024 të datë 30.04.2024, e ka refuzuar si të pabazuar propozimin e propozuesve për caktimin e masës së sigurimit, duke vendosur si në dispozitiv të aktvendimit ankimor.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, ka theksuar se gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën dëgjimore dhe ka konstatuar se nga provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, e duke vlerësuar pretendimet e palëve arriti në përfundim se: provat të cilat janë propozuar me qëllim të argumentimit të fakteve që ndërlidhen me çështjen kryesore sipas kërkesëpadisë së parashtruar mund të ndërlidhen me vërtetimin e tyre për vendosje meritore, ndërsa sa i përket propozimit për caktimin e masës së sigurimit, sipas kushteve ligjore nga neni 297 par.1 pika a) dhe b) vlerësoi se nuk e ka bërë të besueshme kushtin nga pika a) ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij, si dhe kushtin nga pika b) ekzistimin e rrezikut real që do të pamundësonte dukshëm realizimin e kërkesës së tij dhe atë bazuar në faktin se për subjektet kundërshtare të propozimit nuk u parashtrua asnjë provë që do të provonte se ekziston mundësia reale që tani përderisa po trajtohet kjo çështje në procedurë gjyqësore, apo në një të ardhme të afërt, të njëjtit,

kanë ndërmarrë veprime ose do të ndërmarrin veprime të cilat do të kishin për qëllim ndryshimin e gjendjes reale –faktike ashtu që do të pamundësohej realizimi i kërkesave të propozuesit, që këto dy kushte duhet të plotësohen në mënyrë komulative në mënyrë që të caktohet masa e sigurimit. Gjykata e shkallës së parë ka ardhur në përfundim se propozuesi i sigurimit nuk e ka bërë të besueshme rrezikun të cilin e pretendon, dhe nuk ka ofruar prova që vërtetojnë rrezikun real dhe konkret që kundërshtari i sigurimit do ta vështirësojë realizimin e kërkesës së propozuesit të sigurimit. Për mënyrën e vendosjes si në aktvendimin e atakuar, gjykata e shkallës së parë i është referuar dispozitës së nenit 297 par.1 pika a) dhe b) të LPK-së.

Gjykata e Apelit e pranon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar më ankesë nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK, për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkeljet e tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Në këtë drejtim, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, me dispozitën e nenit 297, paragrafi 1 pika a) dhe b) dhe 297 paragrafi 2 të LPK, përcaktohet në mënyrë të qartë se *“Masa e sigurimit mund të caktohet në qoftë se plotësohen në mënyrë kumulative tri kushte dhe atë: besueshmëria ekzistimit të kërkesës apo të së drejtës subjektive, ekzistimi i rrezikut se pa caktimin e masës së sigurimit do të pamundësohet apo vështirësohet dukshëm realizimi i kërkesës dhe deponimi i garancionit”*. Në çdo rast kur nuk plotësohet ndonjëri nga kushtet e sipër theksuara atëherë gjykata nuk mund të vendosë për aprovimin e kërkesës për sigurimin e kërkesëpadisë.

Meqenëse, aktvendimi ankimor përmban dispozitiv të kuptueshëm, ndërsa në arsyetim janë paraqit arsye të plota dhe të kuptueshme për të gjitha faktet të cilat kanë qenë me rëndësi për gjykimin e drejtë të kësaj çështje kontestimore, për këtë arsye thëniet e propozuesit të sigurimit lidhur me atë se aktvendimi ankimor është rrjedhojë e shkeljeve qenësore nga dispozitat e nenit 182 par.1 dhe 182 par.2, pika n) të LPK-së, janë të pabazuara dhe si të tilla janë refuzuar.

Në rastin konkret Gjykata e Apelit e pranon përfundimin e gjykatës së shkallës së parë për mos caktimin e masës së sigurimit, për shkak se ka arsyetuar në masë të mjaftueshme përfundimin e saj për refuzimin e caktimit të masës së sigurimit. Në rastin konkret sipas kërkesës së propozuesve është detyrimi i kundërshtarit të sigurimit që të fshije të gjitha postimet dhe komentet që kane të bëjnë me propozuesit e sigurimit, derisa të përfundoj procedura me aktgjykim nga gjykata në lidhje me këtë padi, janë kërkesa për të cilat vendoset sipas asaj se çka rezulton në fund të procedimit të çështjes kryesore pas vërtetimit të gjendjes faktike dhe aplikimit të dispozitave ligjore për çështjen konkrete, për faktin se me padi kanë kërkuar kompensimin e dëmit, si dhe ndalesa si në propozim për masë të sigurisë, ndërsa me dispozitën e nenit 300 paragrafi 3 të LPK-së, është e përcaktuar se: *‘Masat e sigurimit nga ky nen nuk guxojnë në tërësi ta përfshijnë kërkesën që sigurohet me anë të tyre’*. Gjykata e Apelit vlerëson se në kontekstin e rrethanave të paraqitura në këtë çështje juridike kontestuese e që i referohen pretendimeve të propozuesit të sigurimit lidhur me rrezikun e mundshëm dhe propozuesit t’i pamundësohet

realizimi i të drejtës për vërtetimin faktit, pa e prejudikuar përfundimin meritator të çështjes, në këtë fazë të procedurës konsiderohet i drejtë qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë se caktimi i masës së sigurimit në këtë fazë të procedurës nuk është i arsyeshëm dhe i bazuar. Mirëpo, kjo nuk do të thotë që me ndryshimin e rrethanave në secilën fazë të procedurës, pala propozuese të mos ketë të drejtë të bëjë sërish propozim për caktimin e masës së sigurisë, me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të tij subjektive, pasi që një mundësi të tillë e lejojnë dispozitat ligjore të LPK-së.

Gjykata e Apelit i ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera ankimore të paraqitura në ankesë, por ka gjetur se janë të pathemelta dhe se nuk ndikojnë që gjykata të merre një vendim ndryshe.

Përfundimisht, Gjykata e Apelit i ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë, por nuk ka gjetur se ekziston ndonjë shkelje e cila do të ndikonte që vendimi të kualifikohet si i tillë për çka çështja pastaj do të duhej të kthehej në rishqyrtim.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 208 dhe 209 pika (b) e LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CA.nr.9785/2024, me datë 25.09.2024

Kryetare e kolegjit
Naime Ahmeti, d.v.